Syri i Vizionit

Raport nga Monitorimi i Zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës

Prill, 2012 Prishtinë

Raport nga Monitorimi

i zbatimit të Ligjit

për Mbrojtjen e Natyrës

Prishtinë, prill 2012

Përmbajtja

Raporti për Mbrojtje të Natyrës 3
Përmbajtja 4
Shkurtesat 5
Hyrja 6
Organizata Joqeveritare "Syri i Vizionit".....7
Përshkrimi i Projektit.....7
Metodologjia 8
Aktivitete e Projektit 9
Raporti "Monitorimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës" 11
Përmbledhje e Përgjithshme Raportit 12
Gjendja Reale 13
Institucionet Përgjegjëse për Mbrojtje të Natyrës dhe Zbatimi i Ligjit 15
Zbatimi i Përgjegjësive që Ligji u jep Institucioneve.....16
Nxjerrja e akteve nënligjore 16
Përshtatja e Udhëzimeve të vjetra me Ligjin e ri.....18
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 19
Shpallja dhe Evidentimi i Zonave të Mbrojtura të Natyrës 20
Ndërhyrjet në Zonat e Mbrojtura 20
Financimi i Mbrojtjes së Natyrës 21
Dispozitat Ndëshkimore 22
Zbatimi i Përgjegjësive të Institutit për Mbrojtje të Natyrës 23
Zbatimi i Përgjegjësive në Nivel Lokal- Komunat.....24
Konkluzionet dhe Rekomandimet 26
Foto 28

Shkurtesat

Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Kosovës
Qeveria	Qeveria e Republikës së Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AMMK	Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
DMM	Departamenti për Mbrojtje të Natyrës
KK	Komunat e Kosovës
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
SPVB	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet
OJQ	Organizata Joqeveritare
SiV	Syri i Vizionit
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik

I. HYRJE

Kosova njihet si një ndër vendet me pasuri të mëdha natyrore dhe këtë e konsideron si një nga resurset e saj më të mëdha, [1] dhe kjo shfqet edhe në raportet e ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që merren me natyrën. Në aspektin e saj zhvillimor Kosova, është orientuar në zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë, si dy nga shtyllat kryesore për zhvillim ekonomik.
Sa i përket turizmit Kosova pretendon zhvillimin nga turizmi i natyrës, bazuar në promovimin e jetës së shëndetshme dhe pamjet e ambientit të pastër. Pas përfundimit të luftës, natyra filloj të degradohet pasi që nuk iu kushtua shumë rëndësi ruajtjes së pasurive dhe vlerave të saj po shkatërrohen pyjet, po dëmtohen peizazhet dhe ka një veprim të gjithanshëm dëmtues në natyrë. Me gjithë një bazë ekzistuese të ligjeve nga sistemi i ish Jugosllavisë, në vitin 1976 Kosova ka pasur Ligjin për Mbrojtje të Natyrës ("GZK" nr. 44/76) [2], nuk kishte mekanizma për t'i zbatuar ato ligje për ruajtjen e natyrës dhe vlerave të saj, pasi që institucionet ishin në krijim e sipër, ndërsa veprimi i tyre ishte i kufizuar. Edhe pas krijimit të institucioneve, prapë se prapë ruajtja e natyrës nuk u bë një ndër prioritetet e institucioneve, dhe kjo gjë bëri që Kosova të pësojë një degradim të natyrës, të humbë jashtëzakonisht shumë pasuri natyrore brenda zonave të mbrojtura, peizazheve natyrore, në fushën e biodiveritetit (florës dhe faunës) etj.
Në vitin 2006, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin e ri për mbrojtje të natyrës **Ligji Nr. 02/L-18** . Mirëpo ky ligj gjatë zbatimit të tij kishte hasur në problematika të shumta dhe ishte kritikuar se nuk ishte në harmonizim të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian sa i përket mbrojtjes së natyrës, edhe pse në hyrje të tij thuhej se *"Kuvendi i Kosovës në mbështetje të Rregullores nr. 2001/9 të dt. 15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1 (f), 5.7, 9.1 .26 (a), 9.3.3, duke parë nevojën për të sjellë standarde mbi mjedisin në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian dhe me qëllim për të mundësuar një mjedis të shëndetshëm në rritje për popullin e Kosovës miraton ligjin...".* [3]
Duke e parë këtë gjë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2010, kishte iniciuar plotësim ndryshimin e këtij ligji për ta harmonizuar me direktivat e legjislacionit evropian duke krijuar edhe një grupin punues për të bërë plotësim ndryshimin e këtij ligji. Ky grup punues për plotësim ndryshimin e ligjit ka arritur të harmonizojë ligjin më direktivat e BE-së, duke bërë që Kosova të jetë më afër përmbushjes së obligimeve që ka, andaj ligji i ri është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe që nga 09 nëntori i vitit 2010, është në fuqi me emrin Ligji për Mbrojtjen e Natyrës **Nr. 03/L-233.** [4] Përveç miratimit të këtij ligji, janë nxjerrë 6 udhëzime administrative dhe janë në procedurë e sipër edhe dhjetë udhëzime tjera. Po ashtu është në procedim Ligji për parkun nacional "Sharri", ligji për shpalljen e parkut nacional "Bjeshkët e Nemuna", që kanë kaluar dëgjimin e parë në Kuvendin e Kosovës, si dhe janë nxjerrë katër vendime nga Qeveria për ruajtje të zonave më të rëndësishme si pasuri kombëtare natyrore. Ndërsa në fund të vitit 2011 është hartuar edhe "**Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitet 2011 – 2020",** e miratuar nga Parlamenti i Kosovës**,** më 07.10.2011. [5]

---

1 Ligji për themelimin e Entit krahinor për Mbrojtje te Natyrës ("GZK" 15/81)
2 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës 1976 ("GZK" Nr.44/76)
3 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës 02/L-18 (2005)
4 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 (2010)
5 Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011 – 2020

II. ORGANIZATA JOQEVERITARE "SYRI I VIZIONIT"

Organizata "Syri i Vizionit" në mbështetje të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), ka monitoruar gjendjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të natyrës dhe akteve tjera ligjore që kanë dal nga ky ligj, për të parë se sa janë duke u zbatuar në terren. Pasi që deri më tani nuk është bërë ndonjë monitorim i zbatimit të këtij ligji dhe akteve tjera nënligjore, ky raport do të mund t'ju ndihmojë institucioneve përkatëse që të përmirësojnë efikasitetin e tyre në mënyrë që ky ligj dhe aktet tjera ligjore të gjejnë zbatueshmëri efektive në terren.

Organizata "Syri i Vizionit" është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë që nga 1999 si organizatë e bazuar në komunitet në komunën e Pejës me aktivitete rinore. "Syri i Vizionit" ka arritur profesionalizëm në implementimin e një spektri të gjerë të projekteve të ndryshme, duke e dëshmuar veten si aktor të mirëfilltë i shoqërisë civile në Kosovë.

Syri i Vizionit ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë. Në përpjekjet e vazhdueshme për praktika demokratike, "Syri i Vizionit" i jep rol të veçantë promovimit të qeverisjes së mirë, përgjegjësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes në sferat e ndryshme të shoqërisë civile. [6]

III. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Duke e parë degradimin e vazhdueshëm të natyrës dhe mungesën e veprimeve të duhura nga ana e institucioneve përgjegjëse për ruajtje të natyrës, ashtu siç kërkohet më Ligjin për Mbrojtje të Natyrës, organizata joqeveritare "Syri i Vizionit" në mbështetje të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), që nga nëntori 2011 ka implementuar projektin "Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të Natyrës", për të parë se sa është duke u zbatuar ky ligj në terren, sa janë nxjerrë udhëzimet e duhura administrative në përputhje me këtë ligj dhe sa janë harmonizuar ato me përmbajtjen e tij. Projekti ka pas për qëllim të nxjerrë në pah se cilat janë problematikat me të cilat ballafaqohen institucionet qendrore dhe lokale në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë implementimit të këtij projekti janë përfshirë të gjitha institucionet dhe grupet tjera të interesit nga niveli lokal dhe ai qendror .

---

6 www.syriivizionit.org

IV. Metodologjia

Janë realizuar takime individuale me institucione të nivelit qendror siç janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Mbrojtje të Natyrës, Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Planifikim Hapësinor, me kryetarët e nënkryetarët e komunave, përkatësisht zyrtarët përgjegjës për mbrojtje të mjedisit nëpër komunat e Kosovës, si dhe me shoqërinë civile aktive nga sektori për mbrojtje të mjedisit.

Pas takimeve individuale me të gjithë këto institucione është krijuar një pasqyrë e qartë se çfarë kanë bërë këto institucione nëpër komunat e tyre dhe cilët janë mekanizmat ligjorë në bazë të të cilëve ata veprojnë për të mbrojtur natyrën.
Janë mbajtur tri debate publike me qytetarë, një në Prishtinë dhe një në Pejë, me pjesëmarrje të të gjithë institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit, si dhe një konferencë për media në Prishtinë, në të cilën janë publikuar të dalat nga monitorimi mbi zbatueshmërinë e ligjit në teren. Në këtë konferencë kanë marr pjesë përfaqësues të Ministrisë, përfaqësues të komunave të Kosovës, Instituti për mbrojtje të natyrës dhe përfaqësues nga shoqëria civile.
Nga këto debate dhe konferenca është pasqyruar qartë gjendja e bashkëpunimi dhe koordinimit të aktiviteteve të të gjithë akterëve përgjegjës në zbatimin e ligjit në terren. Në fund të projektit është nxjerrë një raport përfundimtar, së bashku me rekomandimet të cilat janë nxjerr si rezultat i këtij monitorimi. Ky raport do t'i dorëzohet Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim hapësinor si institucion përgjegjës në monitorimin e zbatimit të këtij ligji në terren, si dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë si institucion përgjegjës për zbatim të plotë të këtij ligji në Kosovës.

V. AKTIVITETET E PROJEKTIT

1. Mbajtja e takimeve informuese

1.1 Takime me komisionin parlamentar- Në fillim të muajit nëntor 2011, kur edhe ka filluar projekti, është mbajtur një takim me kryetarin e Komisionit Parlamentar të BPMPH-së, ku është njoftuar me projektin si dhe është kërkuar nga ai që të jetë pjesë e takimeve dhe aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë implementimit të këtij projekti.

1.2 Takime me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor, janë mbajtur disa takime, ku ata fillimisht janë njoftuar me projektin, si dhe është kërkuar nga ta që të jenë pjesë e aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë implementimit të projekti. Po ashtu janë mbajtur disa takime edhe me zyrtarët e zyrës ligjore dhe divizionit për mbrojtje të natyrës që janë në kuadër të MPH-së.

1.3 Takime me zyrtarët e ambientit në dhjetë komunat e Kosovës (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Istog, Klinë dhe Deçan)

1.4 Janë mbajtur takime edhe me kryetarët dhe nënkryetarët e disa komunave të Kosovës. Zyrtarët komunal janë njoftuar me projektin është biseduar edhe për punën dhe angazhimin e tyre në zbatimin e ligjit për mbrojtje të natyrës dhe është kërkuar bashkëpunimi i tyre gjatë realizimit të këtij projekti.

2. Organizimi i debateve publike

2.1 Mbajtja e takimit publik me institucione përgjegjëse për zbatimin e ligjit, (Ministrinë MPH-se, Komisionin parlamentar, Institutin për Mbrojtjen e Natyrës, zyrtarë komunalë dhe ekspertë ligjorë dhe ambientalistë). Në këtë takim publik që është mbajtur në Prishtinë kanë marrë pjesë të gjithë akterët, është diskutuar për punën, angazhimin dhe koordinimin e veprimeve që ata kanë ndërmarrë në zbatimin e ligjit dhe akteve tjera nënligjore që dalin nga Ligji për Mbrojtje të Natyrës.

2.2 Mbajtja e debatit më shoqërinë civile, bizneset dhe qytetarët
Debati për masat ndëshkimore që parashihen në ligj, është mbajtur në Pejë, ku kanë marrë pjesë akterë të ndryshëm që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit. Qëllimi i këtij debati ka qenë njoftimi i bizneseve dhe qytetarëve për masat ndëshkimore, që ata mund të kenë në rast të dëmtimit të natyrës dhe vlerave natyrore, qoftë në zonat e mbrojtura apo edhe jashtë tyre.

2.3 Konferencë për media dhe prezantimi i të dalave nga debatet.
Qëllimi i kësaj konference ka qenë sensibilizimi i opinionit publik për ekzistimin e mekanizmave ligjor për mbrojtje të natyrës dhe fuqizimin e këtyre institucioneve përgjegjëse.

3. Fushata informuese

3.1 Shpërndarja e broshurave/fletëpalosjeve në 7 qendrat kryesore të Kosovës, duke angazhuar vullnetarë të cilët i kanë shpërndarë këto materiale. Duke e parë që mungon informimi i qytetarëve sa i përket ekzistimit të ligjit për mbrojtje të natyrës dhe vlerave natyrore që ka Kosova dhe dëmet që po i shkaktohen natyrës, janë shtypur broshura, ku është publikuar pjesa themelore e këtij ligji, qëllimi i ligjit dhe masat mbrojtëse.

1. Raporti përmbledhës

4.1 Hartimi i raportit më rekomandime nga zbatueshmëria e ligjit dhe dorëzimi i këtij raporti institucioneve përgjegjëse MMPH-së, dhe komisionit parlamentar. Raporti do t'u shërbejë këtyre institucioneve që të njoftohen me zbatimin e ligjit në terren dhe aktivitetet që ata duhet të ndërmarrin, në mënyrë që ligji të gjejë zbatueshmëri në terren.

4.2 Mbajtja e konferencës për media për të prezantuar raportin final me rekomandime me të dalat nga monitorimi i zbatueshmerisë së Ligjit për mbrojtje të natyrës. Përveç që i dorëzohet Ministrisë së MPH-së dhe Komisionit parlamentar të BPMPH-së, përmbajtja e raportit bëhet publik edhe për opinionin publik.

VI. RAPORTI "MONITORIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E NATYRËS"

Raporti në formë analitike ka trajtuar se sa është zbatuar ligji dhe aktet tjera nënligjore në terren dhe sa kanë përmbushur obligimet e tyre institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës. Në kuadër të këtij raporti përfshihet puna dhe përgjegjësitë që kanë pasur MMPH-ja, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Komunat, se sa janë realizuar objektivat e tyre dhe obligimet që përcaktohen me ligji dhe cilat janë mangësitë e këtyre institucioneve në zbatimin e këtij ligji konform përgjegjësive që kanë.
Raporti përveç përfshirjes së problematikave dhe të arriturave në mbrojtje të natyrës përfshin edhe aspektin e ndëshkimeve që parashihen me ligj, për të gjithë ata që kanë degraduar natyrën, zbatimin e këtyre masave ndëshkimore në praktikë, buxhetin për mbrojtje të natyrës dhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodevirzitet 2011-2020.

Në pjesën e fundit të raportit janë të përfshira rekomandimet përkatëse që u adresohen institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe akteve tjera ligjore që kanë dalë nga ky ligj.

Raporti përmban mbi 20 faqe, të ndarë në disa kapituj dhe do i dorëzohet Parlamentit të Kosovës, përmes Komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, si institucion përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij ligji në terren. Po ashtu raporti do t'i dorëzohet edhe Qeverisë së Kosovës, përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucion përgjegjës për zbatimin e këtij ligji në terren, si dhe Institutit për Mbrojtje të Natyrës dhe të gjitha komunave të Kosovës.

Shpresojmë që ky raport do t'i ndihmojë të gjitha institucionet që të krijojnë një pasqyrë të qartë për zbatimin e këtij ligji në terren, dhe do të bëjë që këto institucione të ndërmarrin veprime në përmirësimin e mangësive të tyre, të cilat i ka identifikuar organizata jonë gjatë monitorimit të këtij ligji. Gjithashtu rekomandimet të cilat i përmban ky raport i ndihmojnë të gjitha institucionet për hapat konkret që duhet ndërmarrë në ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së natyrës në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

VII. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIT

Organizata Syri i Vizionit që nga muaji nëntor 2011, deri më 30 prill 2012 ka bërë monitorimin e Ligjit për Mbrojtje të Natyrës, në këto komuna: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Istog Klinë, Deçan etj. nga i cili ka hartuar Raportin për zbatimin e Ligjit për mbrojtje të natyrës, që pasqyron gjenden reale se sa është zbaruar ligji në terren nga ana e institucioneve dhe cila është gjendja reale e natyrës në Kosovë.

Raporti jonë ka identifikuar se është duke u zbatuar shumë pak ligji në terren. Nga takimet që kemi pasur më zyrtarë komunalë, shefat për mbrojtje të mjedisit që janë përgjegjës për zbatimin e ligjit nëpër komuna, kemi konstatuar se nuk kanë qenë të njoftuar sa duhet me përgjegjësitë dhe detyrimet që ua përcakton ligji. Madje disa komuna siç është ajo e Prizrenit apo Klinës, nuk kanë qenë në dijeni se që nga viti 2010 ekziston ligji i ri për mbrojtjen e natyrës, prandaj ata vazhdojnë të thirren në ligjin e vjetër të hartuar në vitin 2005, që ende ndodhet në formën elektronike të Gazetës zyrtare. [7] Po ashtu komunat nuk kanë qenë në dijeni për ekzistimin e udhëzimeve administrative që kanë dalë nga ky ligj, ku nga 6 udhëzime sa janë sot, kanë pasur vetëm dy udhëzime administrative që kanë dalë nga ligji i vitit 2005, e që bien në kundërshtim më ligjin e ri.
Komunat asnjëherë nuk kanë raportuar për gjendjen e natyrës në territorin e tyre edhe pse me ligj ato detyrohen çdo vit t'i paraqesin raport Institutit për Mbrojtje të Natyrës dhe Instituti t'i raportojë Ministrisë, por as këto institucione nuk u kanë kërkuar asnjëherë raport komunave. [8]
Përveç komunës së Mitrovicës dhe asaj të Obiliqit asnjë komunë tjetër nuk ka krijuar drejtori të veçantë për mbrojtje të mjedisit, ku hyn edhe mbrojtja e natyrës, menaxhimi me zonat e mbrojtura natyrore, edhe pse me ligj brenda një viti secila komunë që ka të shpallur zona të mbrojtura, peizazhe natyrore etj. Pra, është e obliguar të krijojë drejtori që do të menaxhojë me to.

Sipas zyrtarëve për mbrojtje të mjedisit, komunat nuk kanë pasur asnjë komunikim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, saktësisht Divizionin për mbrojtjen e natyrës, që ata të njoftohen me ligjin dhe aktet tjera nënligjore sa i përket mbrojtjes së natyrës dhe koordinimit të aktiviteteve në terren. [9]

Ministria e MPH-së që nga viti 2010 ky ligji i ri ka hyrë në fuqi, nuk ka arritur t'i nxjerrë dispozitat nënligjore që parashihen brenda një viti të nxirren, siç janë udhëzimet administrative, strategjia dhe planin e veprimit për zonat e mbrojtura. Deri më tani Ministria ka arritur të nxjerrë vetëm 6 udhëzime administrative, ndërsa10 të tjera janë në procedurë e sipër. Madje, më saktësisht dy nga këto udhëzimet administrative janë nga viti 2006 të cilat bien në kundërshtim me ligjin e ri, pasi thirren në nene dhe paragrafë të gabuar, prandaj atyre u duhet bërë plotësimi dhe ndryshimi, që deri më tani nuk është bërë.

---

[7] Intervistë me Galip Belollari, zyrtar për mbrojtje të mjedisit, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim hapësinor në komunën e Prizrenit
[8] Intervistë me z. Çaush Berisha, zyrtarë për mjedis në Komunën e Klinës, me z. Rifat Morina – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës
[9] Intervista me zyrtarë komunale për mbrojtje të mjedisit (natyrës)

VII. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIT

Strategjia dhe plani i veprimit për Biodiversitet 2011-2020 është miratuar nga Parlamenti i Kosovës më 07 tetor 2011, por deri më sot asnjëra prej komunave nuk ka qenë në dijeni për ekzistimin e kësaj strategjie. [10]

Po ashtu Ministria asnjëherë nuk ka bërë mbikëqyrje se sa janë duke zbatuar komunat Ligjin për mbrojtjen e natyrës, a kanë pranuar aktet ligjore të nxjerra nga ta dhe cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohen komunat në ruajte të natyrës. Kjo ka është konstatuar nga takimet dhe vizitat që kemi realizuar nëpër komuna.

Inspektori i mjedisit asnjëherë nuk ka bërë inspektimin e komunave sa u përket ruajtjes së natyrës, sidomos zonave të mbrojtura, pasi që ka vetëm një inspektor për mbrojtje të natyrës brenda ministrisë që e ka të pamundur të mbulojë të gjitha komunat e Kosovës

Deri më tani asnjë dënim nuk është shënuar, shqiptimi i asnjë dënimi të vetëm për shkelje të ligjit për mbrojtje të natyrës edhe përkundër faktit se natyra është dhe vazhdon të degradohet. [11]
Instituti për Mbrojtje të Natyrës si organ kompetent për vlerësimin e gjendjes së natyrës që nga viti 2010 nuk ka arritur të hartojë raport të ri mbi gjendjen momentale të natyrës në Kosovë. Ky institut nuk ka kapacitetet e duhura që me kohe të ofrojë raporte të tilla, t'u ofrojë asistencë komunave për vlerësim profesional për shpallje të zonave të reja të mbrojtura, pasi që në këtë institut janë të punësuar vetëm 3 persona, që kanë një hapësirë për punë shumë të vogël, madje u mungojnë edhe mjetet logjistike, ata nuk posedojnë makinë për dalje në teren, etj. Kjo bën që ky institut ta ketë të pamundur të kryejnë të gjitha obligimet që u janë përcaktuar me ligj. [12]

Gjendja Reale

Kosova ka mbi 100 zona të mbrojtura natyrës dhe në të gjitha këto zona në mungesë të masave parandaluese ka pasur vazhdimisht dëmtime, siç janë prerjet e pyjeve, ndërtimet e shtëpive, bizneseve hoteliere e rekreative, hedhja e mbeturinave, që vërehen pothuajse në secilën prej zonave të mbrojtura natyrore. [13]
Në masë më të theksuar vërehen në Prevallë, Bjeshkët e Nemuna, Ujëvarat e Mirushës, Bifurkacionin e lumit Nerodime, etj. Dëmtime i janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në shpellën e mermerit të Gadimës, si monument i natyrës me rendësi të veçantë, siç janë dëmtimet fizike apo thyerjet e kristaleve, larja mekanike e kristaleve, çarjet që janë krijuar brenda shpellës nga ndërtimet dhe gurthyesit që janë në afërsi të shpellës etj. Edhe pse në vitin 2009 Qeveria e Republikës së Kosovës e kishte marrë nën mbrojtje këtë objekt, prapëseprapë nuk ka gëzuar ndonjë përkujdesje pasi menaxhmenti i saj, që është privat, vazhdon ta dëmtojë pa dashje edhe përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve që i janë dhënë nga ana e Institutit për mbrojtje të natyrës.

---

[10] Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011 - 2020.
[11] Nga intervista me Zyrtarët e Divizionit për Mbrojtje të Natyrës
[12] Intervista me Institutin për Mbrojtjen e Natyrës
[13] Intervistat me zyrtarë komunalë, Institutin dhe Ministrinë e MPH-së, debatet publike dhe vizitat në terren

VII. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIT

Sa i përket problematikës lidhur me bioversitetin, tashmë është hartuar Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitet 2011-2020, por gjuetia ilegale në zonën e Pashtrikut, Bjeshkët e Nemuna, Korenik, Malet e Sharrit etj. po rrezikojnë shkatërrimin e florës dhe faunës. Nga gjuetia ilegale Kosova çdo vit humb me dhjetëra specie të veçanta, siç janë dhia e egër, kaprolli, ariu, etj. E nga dëmtimi i lumenjve nga kompanitë e zhavorrit dhe nga peshkimi ilegale me rrymë, dinamit dhe forma tjera, Kosova ka humbur shumë lloje të peshqve edhe pse ende nuk është bërë hulumtim se sa lloje të peshqve ka në lumenjtë e Kosovës. [14]

---

[14] Raporti Gjendja e Natyrës "Natyra 2008-2009"
Intervista me organizata ambientaliste dhe raportet e Policisë së Kosovës

Kuvendi i Kosovës
Në Kosovë organi më i lartë ligjvënës është Kuvendi i Republikës së Kosovës, i përbërë prej 120 deputetëve. Si trup punues i Kuvendit të Kosovës janë edhe komisionit parlamentare. Si komision i cili është përgjegjës ndër të tjera edhe për natyrë është Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor më 9 anëtarë.

Qeveria e Kosovës
Qeveria e Kosovës është e përbërë nga 19 ministri, në kuadër të këtyre të cilave është edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Mandati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor është përcaktuar me rregulloret e UNMIK-ut Nr. 2002/5 dhe 2005/15. Në kuadër të këtyre rregulloreve përgjegjësitë kanë të bëjnë me krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm në fushën e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit e banimit. Ministria ka ngritur departamente, institute si dhe Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit. Ndër të tjera është përgjegjëse që të krijojë politika dhe të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyrë aktivitete për mbrojtje të mjedisit. Mbikëqyrjen e zbatimin të Ligjit për Mbrojtje të Natyrës dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji e bën Ministria përmes Inspektoratit për mbrojtje të natyrës, që është në kuadër të inspektoratit mjedisor.
Ministria e MPH- së bën mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e kryen Ministria MPH-së përmes Divizionit Mbrojtja e Natyrës.
Mbikëqyrjen e drejtpërdrejt në zonat e mbrojtura e kryejnë drejtoritë për administrimin e zonave të mbrojtura the themeluara nga MPH-ja. Nëse një vlerë e mbrojtur e natyrës shpallet e mbrojtur nga niveli komunal atëherë përkujdesjen për atë e ka komuna.
Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e kryen inspektori i mbrojtjes së natyrës në kuadër të inspektoratit mjedisor në kuadër të MPH-së.

Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës është institucion që është themeluar pas miratimit të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit nga Kuvendi i Kosovës. Në kuadër të këtij Agjencioni janë edhe Instituti për Mbrojtje të Natyrës dhe ai Hidreometerologjik. Detyrat e AMMK-së janë monitorimi i mjedisit, informimi i publikut dhe institucioneve vendore dhe kombëtare për gjendjen e mjedisit në Kosovë, si dhe projekte kërkimore e shkencore nga fusha e mjedisit.

Instituti për Mbrojtje të Natyrës
Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës është institucioni qendror për ruajtjen e natyrës, monitorimin e gjendjes së vlerave të mbrojtura natyrore në Kosovë. Në vitin 2001 me formimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Mbrojtjen e Mjedisit bëhet pjesë e kësaj ministrie, ndërsa në vitin 2006 me themelimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, ai kalon si njësi e këtij agjencioni në kuadër të së cilit vepron edhe tani.

IX. ZBATIMI I PËRGJEGJËSIVE QË LIGJI U JEP INSTITUCIONEVE

1. Nxjerrja e akteve nënligjore

Sipas Ligjit në fuqi për mbrojtje të natyrës, Qeveria dhe Ministria në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet t`i nxjerrin dispozitat për të cilat janë të autorizuara me këtë ligj, në mënyrë që ky ligj të gjejë zbatueshmeri më të lehtë në terren dhe të ndihmojë në ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës ashtu siç është e përcaktuar edhe me rregullat ndërkombëtare për mbrojtje të natyrës. [15] Aktet nënligjore të cilat është dashur të përfundojnë gjatë viti 2011 sipas këtij ligji janë:

- Ligjin për shpallje park kombëtar për zonat e mbrojtura e nxjerr dhe miraton Kuvendi i Kosovës
- Planin e menaxhimit për zonat e mbrojtura në kohëzgjatje dhjetë (10) vjeçare e miraton Kuvendi i Kosovës me propozim të MMPH-së
- Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitet (10) vjeçar po ashtu e miraton Kuvendi i Kosovës me propozim të MMPH-së
- Udhëzimet Administrative i nxjerr MMPH-ja

Edhe pse kanë kaluar dy vite kur ligji i ri për mbrojtje të natyrës, ka hyrë në fuqi ende nuk janë kompletuar të gjitha aktet nënligjore që ligji i parasheh sa i përket ruajtjes së natyrës.
Deri më tani Qeveria dhe Ministria kanë nxjerrë vetëm këto akte ligjore:

1. **"Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitet 2011 – 2020,** miratuar nga Parlamenti i Kosovës**, (**07.10.2011)
2. **Projektligji për Parkun Kombëtar "Sharri"** miratua në parim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 20.12.2011
3. **Projektligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"**, miratuar në parim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 20.12.2011.

Udhëzimet Administrative të Miratuara deri më tani janë:

- Udhëzimi Administrativ *Nr. 08/2011* për grumbullimin e llojeve të bimëve të egra të mbrojtura me qëllim të përpunimit dhe tregtimit.
- Udhëzimi Administrativ *Nr. 12/2011* për llojet e tipave të vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore.
- Udhëzimi Administrativ *Nr. 14/2012*, për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjëzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim.
- Udhëzimi Administrativ *Nr. 01/07* për mënyrën e shënimit të zonave të mbrojtura.
- Udhëzimi Administrativ *Nr. 04 / 2006*, për formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të zonave të mbrojtura të natyrës.
- Udhëzimi Administrativ *Nr. 11/ 07* për planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura të natyrës

---

[15] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës **Nr. 03/L-233, Neni 175** paragrafi 1.

Udhëzimet që ende nuk janë miratuar deri më tani, por që janë në procedurë e sipër:

- Udhëzimi Administrativ për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura.
- Udhëzimi Administrativ për Regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës.
- Rregullorja për rendin e brendshëm të Parkut Kombëtar "Mali Sharr", në shqyrtim nga grupi punues.
- Udhëzimi Administrativ për qarkullimin ndërkufitar dhe tregtinë me llojet e mbrojtura.
- Udhëzimi Administrativ për shenjen e mbrojtjes së natyrës.
- Udhëzimi Administrativ për vendkalimet e shtazëve të egra.
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e dhënies së kartës dhe shenjës zyrtare për inspektorin e mbrojtjes së natyrës.
- Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri"
- Plani Hapësinor për Monumentin e Natyrës me Rendësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushes".
- Udhëzuesi për Planin menaxhues të parqeve kombëtare në Republikën e Kosovës.

Sipas ligjit, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e kryen Ministria, gjë që nuk mund të thuhet se e ka bërë deri më tani. Edhe pse të nxjerra disa nga këto akte nënligjore, shumë pak prej tyre janë bërë publike për publikun dhe institucionet tjera nga ana e Ministrisë së MPH-së. [16]
Komunat në disa raste as nuk janë në dijeni për ekzistimin e këtyre akteve nënligjore siç janë udhëzimet administrative që janë në fuqi tash e sa vite, apo Strategjia dhe plani i veprimit për dioversitet 2011-2020, ashtu siç parashihen më ligj. Këtë gjë e kemi vërejtur nga takimet dhe vizitat që ju kemi bërë komunave dhe takimeve të drejtpërdrejta që kemi pasur me zyrtarët mjedisorë nëpër komuna që njëherit janë përgjegjës për ruajtje të natyrës dhe zbatim të këtyre akteve ligjore në territorin e tyre.
Sa i përket udhëzimeve administrative ato edhe pse ato janë në Gazetën zyrtare, qysh me miratimin e tyre nga ministri, prapë se prapë komunat nuk i kanë pasur, dhe po ashtu ato asnjëherë nuk u janë përcjellë komunave nga ana e MMPH-së, saktësisht nga Divizioni për Mbrojtje të natyrës si institucion përgjegjës për ruajtje të natyrës.

Gjithashtu MMPH-ja edhe pse e ka për obligim që të gjitha aktet nënligjore që janë nxjerrë për mbrojtje të natyrës t'i bëjë publike, jo vetëm përmes publikimit në Gazetë Zyrtare por edhe t'i plasojë ato në ueb sajtin e saj, po në këtë sajt janë të publikuar, Ligji për mbrojtje të natyrës dhe dy udhëzimet administrative: [17]

---

[16] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Neni 158, paragrafi 1.
[17] Udhëzim Administrativ Nr.12/2011, për llojet e tipave të vendbanimeve natyrore,hartat e vendbanimeve natyrore,tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave te vendbanimeve natyrore.

Nga takimet që kemi pasur me Ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, Zyrën ligjore dhe Divizionin për mbrojtje të natyrës, kemi parë që kjo ministri asnjëherë nuk ka bërë ndonjë mbikëqyrje për të parë nëse komunat kanë pranuar aktet ligjore të dala deri më tani, a janë duke i implementuar në terren këto akte ligjore, apo cilat janë sfidat më të cilat ballafaqohen komunat gjatë zbatimit të tyre në terren. Kjo çështje është potencuar edhe në debatet publike dhe në konferencat e organizuara në kuadër të projektit për monitorim e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të Natyrës, në të cilat është konstatuar se disa nga komunat janë njoftuar për herë të parë me udhëzimet administrative që janë nxjerrë dhe janë në procedurë e sipër dhe me Strategjinë dhe Planin e veprimit për biodiversitet 2011-2020. Madje këto aktivitete kanë qenë edhe kontakti i parë për disa zyrtarë komunalë për mbrojtje të mjedisit më Ministrinë. Kjo ka treguar se sa është bashkëpunimi dhe komunikimi i duhur në mes të institucioneve nga niveli lokal më atë qendrore në ruajtjen e natyrës. [18]
Mungesa e mbikëqyrja nga ana e MMPH-së dhe mos shpërndarja e udhëzimeve administrative tek zyrtarët komunalë për mbrojtje të mjedisit, ka bërë që disa nga këta zyrtarë, dhe komunat në përgjithësi, të kenë shumë pak njohuri dhe të humbin interesimin për t'i poseduar dokumentacionin e nevojshëm ligjor: udhëzimet administrative, strategjinë e veprimit, për të hartuar në komunat e planet e tyre të veprimit për ruajtjen e natyrës dhe për ndërmarrjen e masave në kohën kur natyra degradohet për çdo ditë e më shumë në territorin e tyre.
Situata e pasqyruar në këtë raport gjatë monitorimit të ligjit, tregon se sa është punuar në ruajtjen e natyrës dhe sa ka qenë prioritet i institucioneve qendrore dhe atyre lokale por edhe në ruajtje të natyrës. Në radhë të parë komunikim jo i mirë në mes të këtyre dy niveleve të qeverisjes, atij qendror dhe lokal për zbatimin e ligjit, ka bërë që asnjëherë të mos ketë veprime të koordinuara në mbrojtje të natyrës, por në të njëjtën kohë ka ndikuar që edhe vetëdija e publikut në ruajtje të natyrës dhe në ekzistimin e mekanizmave ligjore, të jetë shumë e vogël gjë që shkakton një degradim edhe më të madh të natyrës nga faktori njeri. Stafi i angazhuar në kuadër të Divizionit për mbrojtje të natyrës i përbërë prej pesë personave është i pamjaftueshëm që të bëjë një monitorim të duhur nga ana e MMPH-së, pasi që në kuadër të saj ka vetëm një inspektor, që duhet të inspektojë të gjitha zonat e mbrojtura të Kosovë, që është e pamundur që ai të inspektojë të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

2. Përshtatja e udhëzimet administrative të vjetra me ligjin e ri

Sa u përket udhëzimeve administrative deri më tani që nga ligji i parë i miratuar në 2005 janë nxjerrë gjashtë udhëzime administrative, mirëpo me amendamentimin e këtij ligji në vitin 2010 dhe me hyrje në fuqi të këtij ligji disa udhëzime administrative bien në kundërshtim me nenet në të cilat thirren dhe paragrafët. Dy nga udhëzimet që ende janë në fuqi e që thirren në ligjin e vjetër janë udhëzimet e nxjerra në vitin 2006. [19] Te këto udhëzime duhet të bëhet plotësim ndryshimi i tyre pasi që me këtë ligj këto dy udhëzime nuk janë në përputhje me ligjin e ri dhe krijojnë konfuzion gjatë zbatimit të ligjit në ato nene në të cilat thirren këto dy udhëzime.

---

[18] Debatet publike ne Prishtinë dhe Pejë
[19] Udhëzimi Administrativ *Nr. 04 / 2006*, për formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të zonave të mbrojtura të natyrës. Udhëzimi Administrativ *Nr. 11/ 07* për planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura të natyrës.

3. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitet

Kosovës i ka munguar strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitet ashtu siç kërkohet me ligj, deri në fund të vitit të kaluar (2011), kur është arritur ta hartohet Strategjia dhe Plani i veprimit për Biodiverzitet për 10 vite, që e ka nxjerr Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë dhe e aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin është dokument bazë për mbrojtjen e
natyrës, i cili i përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me
zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Republikës së Kosovës.

Bazuar në Ligjit për mbrojtjen e natyrës, Strategjia përmban: [20]

- qëllimet e përgjithshme strategjike;
- synimet për ruajtjen e peizazheve, ekosistemeve, tipave të vendbanimit,
- llojeve të egra dhe llojeve vendore të zbutura;
- synimet për vlerat e mbrojtura të natyrës;
- synimet për hulumtimet dhe përcjelljen e gjendjes të natyrës;
- synimet për përfshirjen e mbrojtjes së natyrës në sektorët tjerë;
- synimet për kornizën legjislative dhe institucionale;
- synimet për edukim dhe arsimim me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së natyrës
- larmisë biologjike dhe peisazhore;
- synimet për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për natyrën;
- planet e veprimit për zbatimin e synimeve, me theksimin e prioriteteve dhe burimet e mundshme financiare;mënyrën e përmbushjes të detyrimeve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës
- shtojcën hartografike e cila në hapësirë tregon masat e mbrojtjes të larmisë biologjike dhe peisazhore dhe mbrojtjen e vlerave të natyrës.

---

[20] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës- Neni 141, paragrafi 2

4. Shpallja edhe evidentimi i zonave të mbrojtura të natyrës

Kosova ka një hapësirë të mbojtur prej 47.842.34 ha (4.39% e territorit të Kosovës), apo 97 zona të mbrojtura sipas raportit të fundit të Institutit për Mbrojtje të Natyrës 2008-2009. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë 11 rezervate të natyrës, 1 park kombëtar, 82 monumente të natyrës, 2 parqe regjionale të natyrës dhe 1 park i pyllit. Ndërsa në procedim të mëtejmë kanë mbetur edhe 159 zona të tjera të propozuara, përfshirë edhe territorin e "Bjeshkëve te Nemuna" me sipërfaqe prej 60.000 ha, që tashmë është duke u proceduar edhe si Ligji për shpalljen e Park kombëtar të kësaj zone. [21]
Edhe pse ka pasur kërkesa për shpallje të zonave të reja të mbrojtura qoftë nga komunat apo të propozuara edhe nga Instituti, ende nuk dihet se sa është rritur ky numër, edhe pse vitin e kaluar në komunën e Gjakovës është shpallur një zonë e mbrojtur, Shkukëza e Gjakovës me një hapësirë prej 8 ha, gjë që rrit numrin e zonave të mbrojtura në Kosovë. Mirëpo nuk ka ndonjë statistikë zyrtare nëse ky numër është rritur, pasi ende nuk është bërë ndonjë raport për këto dy vitet e fundit 2010-2011, se sa është rritur numri i zonave të mbrojtura dhe cila është gjendja e tyre në përgjithësi. Sipas ligjit për të promovuar mbrojtjen e natyrës dhe identifikimin e personit zyrtar në procedurën e mbikëqyrjes dhe ndërmarrjes së masave për mbrojtjen e natyrës, duhet të përdoret shenja për mbrojtjen e natyrës, dhe duhet të dizajnohet pamja e kësaj shenje. Këtë procedurë dhe kushtet për përdorimin e saj i përcakton ministri me akt nën ligjor. Deri më tani ende nuk është hartuar Udhëzimi Administrativ për shenjën e mbrojtjes së natyrës, shenjë që do të ndikonte në vetëdijesimin e qytetarëve se gjatë vizitave në këto zona ata të njoftohen se ajo zonë është e mbrojtur dhe duhet respektuar, që të mos bëjnë ndonjë veprim të kundërligjshëm duke e dëmtuar natyrën e asaj zone pa qenë të vetëdijshëm për dëmin që shkaktojnë. [22] Nuk ka ndonjë raport për vitin 2010-2011 sa i përket gjendjes së zonave të mbrojtura të natyrës por nuk ka asnjë raport sa i përket gjendjes së natyrës në Kosovë për vitin 2010-2011, për të parë nëse ligji i ri ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes së natyrës nga ajo gjendje që ishte paraqitur në raportin e institutit për mbrojtje të natyrës për vitin 2008-2009.[23]

5. Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura

Mungesa e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i pa kontrolluar i resurseve natyrore në zonat e mbrojtura mbeten një ndër problemet kryesore sa i përket aspektit të mbrojtjes së këtyre zonave. Në këto zona vazhdimisht ka ndërhyrje nga faktori njeri qoftë në fushën e ndërtimeve siç janë ndërtimi i restoranteve , hoteleve, shtëpive, prerja ilegale e pyjeve, gjuetia ilegale në ato zona. Po ashtu dëmtimet që janë shkaktuar edhe nga kushtet atmosferike etj. Këto janë ndër sfidat kryesore që rrezikojnë që këto zona të humbin epitetin e zonës së mbrojtur.
Problematikë tjetër mbetet edhe mungesa e organeve menaxhuese në zonat e mbrojtura. Sipas ligjit, në një afat kohor prej një viti duhet të themelohen drejtori të veçanta që do të menaxhojnë më zonat e mbrojtura.[24]

---

21 Intervistë më z. Rifat MorinaInstituti për Mbrojtjen e Natyrës
22 Udhëzimi Administrativ për shenjën e mbrojtjes së natyrës
23 Raporti Gjendja e Natyrës "Natyra" 2008-2009
24 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës- Neni 153

Sa i përket themelimit të organeve menaxhuese deri më tani është themeluar vetëm Drejtoria e Parkut Nacional "Malet e Sharrit" e themeluar nga MMPH-ja, ndërsa parku "Germia" menaxhohet nga ndërmarrja publike "Hortikultura". Shpella e Mermerit në Gadime ende mbetet nën menaxhimin e një pronari privat, për të cilin është raportuar se po i shkakton dëme kësaj shpelle, edhe pse ka nxjerr vendim nga Qeveri për ta marr nën menaxhim këtë objekt të rëndësishëm nuk ka arritur ta marrë nën menaxhim. Ndërsa zonat tjera nuk menaxhohen nga askush dhe kanë mbetur në mëshirën e kohës dhe njerëzve, pasi nuk janë krijuar ende mekanizma apo drejtori që të menaxhojnë drejtpërdrejt me këto zona të mbrojtura, ashtu siç është përcaktuar me ligj. Janë themeluar edhe dy drejtori komunale për mbrojtje të mjedisit, ajo në komunën e Mitrovicës dhe në komunën e Obiliqit, ndërsa komunat tjera kanë vetëm nga një zyrtar për mjedis që përveç mbrojtjes së mjedisit merret edhe me mbrojtje të natyrës. Mos krijimi i drejtorive komunale për menaxhim të këtyre zonave ka bërë që këto zona vazhdimisht të dëmtohen dhe të shfrytëzohen pa pasur mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të kujdesit, qoftë nga institucionet qendrore apo edhe ato lokale.

Sipas këtij ligji, në zonën e mbrojtur lejohen ato ndërhyrje dhe punë të cilat nuk i dëmtojnë dhe nuk i ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është shpallur e mbrojtur. Për punët dhe ndërhyrjet në zonën e mbrojtur për të cilat sipas dispozitës së veçantë nuk nevojitet marrja e lejes për lokacion, përkatësisht të zbatohet procedura e vlerësimit që sa është e pranueshme një veprimtari në natyrë, lëshohet leja.
Lejen për ndërhyrjet dhe punët në rezervatin strikt, zonën e veçantë, parkun kombëtar, parkun e natyrës dhe monumentin e natyrës e lëshon Ministria.[25] Mirëpo në të gjitha këto zona janë ndërtuar edhe ende vazhdojnë të ndërtohen objekte të ndryshme qoftë shtëpi banimi, restorante, hotele etj, siç është rasti me Prevallën që është pjesë e Parkut Kombëtar "Mali Sharr", po ashtu ndodh edhe me "Bjeshkët e Nemuna", e situatë e njëjtë është edhe në zonat tjera të Kosovës, ku ndërtimet dhe veprimet e njeriut në ato zona bëhet pa kontroll apo pa një plan menaxhimi për zhvillimin e atyre zonave dhe llojet e ndërtimeve që lejohen apo që ndalohen aty.

6. Financimi i mbrojtjes së natyrës

Përveç përcaktimit të masave të mbrojtjes dhe administrimit me natyrën, ky ligj ka të përcaktuar edhe aspektin e financave, se si duhet krijuar buxheti dhe cilat institucione janë përgjegjëse për sigurimin e buxhetit për të ruajtur natyrën. Në ligj thuhet se nga Buxheti i Kosovës sigurohen mjetet për mbrojtjen e vlerave të natyrës me rendësi kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe për ato vlera të natyrës të cilat i përcakton Ministria, për mbështetje financiare dhe mbështetje të tjera të përcaktuara me këtë ligj, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga shtazët strikt të mbrojtura, për realizimin e të drejtës së parablerësit të Republikës së Kosovës, për kompensimin e pronarëve ose bartësve të së drejtës në patundshmëri, për kufizimet të cilave u janë nënshtruar nga mbrojtja e vlerave të natyrës me rëndësi ndërkombëtare dhe shtetërore si dhe për qëllime të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

---
[25] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës -, Neni 128

Mirëpo gjatë këtyre dy viteve nuk është ndarë një buxhet i veçantë nga buxheti i Kosovës për të investuar në ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës, mungesa buxhetore ka ndikuar që të mos themelohen drejtoritë për menaxhim me zonat e mbrojtura, si dhe të hartohen raportet për gjendjen e natyrës, evidentimin e florës dhe faunës, dhe studime tjera të cilat ka për obligim t'i bëjë Instituti për Mbrojtje të Natyrës dhe vetë Ministria e MPH-së

Nga buxheti i komunës sigurohen mjetet për mbrojtjen e vlerave të natyrës të cilat ajo i shpall, për mbështetje financiare dhe mbështetje tjera të përcaktuara me këtë ligj si dhe për realizimin e të drejtës së blerësit të parë dhe kompensimin e pronarëve dhe bartësve të së drejtës në patundshmëri për kufizimet të cilave u janë nënshtruar ato vlera të mbrojtura të natyrës. Po ashtu asnjë komunë nuk ka ndarë nga buxheti i saj ndonjë buxhet të veçantë siç kërkohet me ligj, mundësia e vetme ku mund të përfitojë natyra nga buxheti komunal është nëse drejtoria për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, ku bënë pjesë edhe zyrtarët e ambientit, shprehë vetë dëshirën për të ndarë para për mbrojtje të natyrës, edhe pse buxheti komunal është jo i kënaqshëm sa që t'ua mundësojë këtyre zyrtarëve komunalë të bëjnë diçka për ruajten dhe përkujdesin më të madh ndaj natyrës. [26]

Mjetet për financimin e mbrojtjes së natyrës sigurohen nga shfrytëzimi i të mirave të natyrës dhe vlerave të mbrojtura të natyrës nëse me këtë ligj ose me ndonjë ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe, kompensimet nga dhënia me koncesion dhe nga burime tjera të përcaktuara me ligj ose dispozitat e nxjerra në bazë të ligjit. Sa i përket kësaj çështje edhe pse ka shumë biznese dhe qytetarë që përfitojnë në shfrytëzimin e të mirave të natyrës, prapë se prapë komunat nuk përfitojnë asgjë nga kjo, pasi që nuk kanë mekanizma për kontroll dhe inspektim të duhur në këto zona.

7. Dispozitat Ndëshkimore

Sa u përket dispozitave ndëshkimore, ato janë mjaft të larta dhe do të garantonin një mbrojtje të mirë të natyrës, po të zbatoheshin në praktikë. Sipas Ligjit për Mbrojtje të Natyrës, gjoba më e lartë është dyzetmijë (40.000) euro, [27] me të cilën do duhej të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse kryen ndërhyrjen ose veprimin, i cili mund të asgjësojë ose shkaktojë dëm të madh ose të përhershëm në zonën e rëndësishme ekologjike (neni 63 paragrafi 4. dhe neni 64 paragrafi 4. të këtij ligji) apo nëse do të zhdukë llojin e egër autokton (neni 86 paragrafi 3. të këtij ligji). Ndërsa masa ndëshkimore më e ulët, sipas këtij ligji, me gjobë në vlerë prej tridhjetë (30) euro, mund të jepet për kundërvajtje personit fizik nëse bën vizita dhe/ose shikimin pa biletë në vende ku bileta është e detyruar; (neni 75 paragrafi 1. pika 1.9. i këtij ligji) apo nëse hedh mbeturina në vendin, i cili nuk është paraparë dhe i shënjuar për to (neni 75 paragrafi 1. Pika 1.10 i këtij ligji). [28] Por deri më tani nuk është shqiptuar asnjë masë ndëshkimore sa u përket gjithë atyre personave fizikë apo juridikë që kanë rënë në kundërshtim më këtë ligj sa i përket mbrojtjes së natyrës për vitin 2011. [29]

---

[26] Intervista me shefat e mjedisit nëpër komuna
[27] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës- Neni 164
[28] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës- Neni 167
[29] Intervista me zyrtarë mjedisorë komunalë dhe Ministrinë e MPH-së

X. ZBATIMI I PËRGJEGJËSIVE TË INSTITUTIT PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me. [30]

Që nga hyrja në fuqi e ligjit të ri për mbrojtje të natyrës në vitin 2010, Instituti për mbrojtje të natyrës nuk ka arritur të publikojë ndonjë raport të ri mbi gjendjen e natyrës, edhe pse me ligj ky institut obligohet të hartojë raport çdo dy vite mbi gjendjen e natyrës, që duhet t'i dorëzojë Ministrisë së MPH-se dhe pasi të vërtetohet nga MMPH-ja raporti ato duhet t'i raportojnë Kuvendit të Kosovës. Raporti i fundit i publikuar nga IMNK-ja është për vitin 2008-2009, dhe në vitin 2010 për herë të parë Ministria i ka raportuar Parlamentit për gjendjen e natyrës në Republikën e Kosovës. Instituti edhe pse nuk ka arritur të nxjerrë raportin për gjendjen e natyrës për vitin 2010-2011, u ka ofruar ndihmë profesionale komunave për të vlerësuar zonat natyrore që komunat i shohin me interes për t'i shpallur si zona të mbrojtura.

Instituti për Mbrojtje të Natyrës nuk ka kuadër të mjaftueshëm për të monitoruar të gjitha zonat natyrore dhe për t'i kryer të gjitha obligimet që ua përcakton ligji, pasi që në këtë institucione janë të punësuar vetëm 3 persona, që duhet të mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Kosovës për të hartuar raporte mbi gjendjen e natyrës, për të ofruar këshilla dhe për të bërë vlerësime profesionale për komunat për shpalljen e zonave të reja. Stafi shumë i vogël që ka për momentin IMNK-ja është i pamjaftueshëm për të kryer detyrat e veta: për të siguruar me kohë raportet, për të bërë vlerësime profesionale, për t'iu ofruar asistencë komunave për shpalljen e zonave të reja, për të ofruar raport të hollësishme për gjendjen e natyrës në përgjithësi.
Madje përveç stafit të vogël që ka, këtij instituti i mungon edhe hapësira e punës, pasi hapësira në të cilën ata punojnë është shumë e vogël për të kryer punët e tyre profesionale. Gjithashtu Institut nuk ka edhe logjistikë të mjaftueshme për të realizuar punën e tyre në terren, madje nuk posedojnë as një makinë që do t'u lehtësonte vizitat e tyre më të shpeshta në terren.

---

[30] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233

XI. ZBATIMI I PËRGJEGJËSIVE NË NIVELIN LOKAL-KOMUNAT

Komunat janë institucioni lokal që duhet të përkujdesen për natyrën në territorin e tyre, sipas ligjit**,** komunat në pajtim me këtë ligj, duhet të hartojnë strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor. [31]

Komunat janë shumë pak të informuara me përgjegjësitë që kanë, të cilat ua ka përcaktuar Ligji për mbrojtje të natyrës. Ato nuk kanë themeluar drejtori për menaxhim të zonave të mbrojtura dhe fusha tjera që përcakton ligji për mbrojtje të natyrës, pasi që nuk kanë mundësi buxhetore për krijimin e drejtorive të reja siç janë drejtoritë për menaxhimin e zonave të mbrojtura në territorin e komunave të tyre. Vetëm dy komuna i kanë krijuar këto drejtori për mbrojtje të mjedisit: komuna e Mitrovicës dhe komuna e Obiliqit. [32] Të gjitha komunat tjera kanë vetëm nga një zyrtar që merret me mbrojtje të mjedisit, zyrtarë që kryesisht veprojnë në kuadër të drejtorive për urbanizëm, planifikim hapësinor dhe mjedis.
Komunat nuk kanë të hartuar ndonjë plan të veprimit apo program për mbrojtje të natyrës siç parasheh ky ligj [33] "Dokumentet bazë për mbrojtjen e natyrës". Komunat detyrohen që të nxjerrin programet për mbrojtjen e natyrës për territorin e vet, gjë që nuk e ka bërë asnjë komunë. Të vetmet programe që komunat kanë bërë janë Planet e veprimit në mjedisin, që i obligon Ligji për mbrojtje të mjedisit, i cili është i vetmi dokument me të cilin pushteti lokal mundohet të mbrojë sadopak natyrën nëpër teritoret e komunave.

Sa i përket raportit mbi gjendjen e natyrës, në territorin e vet asnjë komunë nuk ka hartuar ndonjë raport mbi gjendjen e natyrës, raporte këto që do të duhej t'i dorëzohen Institutit për Mbrojtje të Natyrës dhe Ministrisë së MPH-së, që këto institucione të njoftohen me gjendjen e natyrës nëpër komunat e Kosovës. [34] Përveç që nuk i kanë hartuar këto raporte që janë të obliguara, institucionet lokale për mbrojtje të mjedisit, në këtë rast mbrojtjes së natyrës, asnjëherë nuk kanë njoftuar publikun për gjendjen në natyrë, asnjeherë nuk kanë organizuar ndonjë fushatë, konferencë për media apo ndonjë takim publik më qytetarë për t'i njoftuar me mekanizmat ligjorë që të ngritet edhe vetëdija e publikut me mekanizmat ligjorë për ruajte të natyrës.
Gjithashtu, asnjëra nga komunat nuk ka njoftuar publikun për gjendjen e natyrës në territorin e tyre dhe masat që ata kanë ndërmarr për ruajtjen e natyrës, ashtu siç parashihet me ligj. [35] Madje nuk ka pasur ndonjë fushatë vetëdijësuese për qytetarët për të promovuar vlerat natyrore që posedojnë komunat, apo për të promovuar legjislacionin ekzistues për mbrojtje të natyrës.

---

[31] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës- Neni 143, paragrafi 2.
[32] Intervistë me përfaqësues nga Sektori për mbrojtjen e vlerave të natyrës dhe biodiversitet znj.Miradije Gerguri, z. Ismail Hetemaj Divizionit për mbrojtjen e natyrës dhe debatet e realizuara në Prishtinë e Pejë
[33] Neni 140, paragrafi 1 dhe 2, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
[34] Neni 143, paragrafi 2.7, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
[35] Neni 143, paragrafi 2.9, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Gjatë kësaj kohe nuk ka pasur asnjëherë ndonjë takim publik për të diskutuar për gjendjen e natyrës edhe pse për çdo ditë në secilën komunë bëhet degradim shumë i madh i natyrës, sidomos në fushën e biodiversitet, ku janë të rrezikuar flora dhe fauna. Po ashtu komunat nuk janë në dijeni me vendimet dhe planet që nxjerr apo ndërmerren nga institucionet qendrore, në këtë rast Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas tyre, ata nuk informohen me kohë, qoftë gjatë hartimit të Ligjeve, strategjive apo udhëzimeve administrative, e ato nuk u përcillen me kohë as pas miratimit të tyre. [36]
E tërë kjo reflekton që zyrtarët për mbrojtje të mjedisit, nuk dinë edhe se si të veprojnë apo çfarë duhet ndërmarrin në ruajtje të natyrës, pasi në mungesë të informative mbi aktet ligjore, të gjithë përgjegjësinë për ruajtje të natyrës e hedhin tek Ministria e MPH-së.
Pjesa më e madhe e komunave, sidomos komunave më të mëdha siç janë Prizreni, Gjilani, Peja, Mitrovica, Prishtina etj, përveç që nuk kanë udhëzimet administrative me të cilat do të duhej të punonin në zbatimin e ligjit në teren, ato nuk kanë qenë të njoftuara dhe nuk kanë qenë pjesëmarrëse në hartimin e **Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiverzitet 2011 – 2020,** të miratuar nga Parlamenti i Kosovës në tetor 2011, në bazë të së secilës edhe komunat kanë obligime që duhet përmbushur gjatë këtyre 10 viteve. Gjatë vizitës dhe intervistave me zyrtarë të zhvilluara nëpër këto komuna, kemi vërejtur se ato kanë vetëm një ose dy udhëzime që janë miratuar vite më parë, siç janë Udhëzimi Administrativ *Nr. 04 / 2006*, për formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të zonave të mbrojtura të natyrës dhe Udhëzimin Administrativ *Nr. 08/2011* për grumbullimin e llojeve të bimëve të egra të mbrojtura me qëllim të përpunimit dhe tregtimit.

Gjithashtu komunat nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në ruajtjen e larmisë biologjike dhe peisazhore për territorin e vet në mungesë të buxhetit dhe stafit që iu nevojitet për të ndikuar në ruajte të larmisë biologjike dhe pejsazhore. Po ashtu gjatë punës sonë në monitorim të zbatimit të ligjit, kemi vërejtur se mungon komunikimi dhe kontaktet e nevojshme mes Ministrisë së MPH-së dhe komunave. Komunikimi jo i mjaftueshëm i këtyre institucioneve shumë të rëndësishme për ruajte të natyrës ka bërë që komunat të jenë pasive në ruajtje të natyrës dhe të jenë pak të informuara me legjislacionin ekzistuese dhe të mos kenë buxhet të mjaftueshëm qoftë nga Kuvendi komunal, Qeveria apo Ministria e MPH-së.

---

[36] Debatet publike në Prishtinë dhe Pejë dhe intervista më zyrtarë komunalë

XII. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

- Qeveria e Republikës së Kosovës dhe MMPH-ja duhet të ndajë një buxhet të veçantë për mbrojtje të natyrës dhe për investim të duhur në ato zona ku shihet se ka nevojë emergjente, që ky buxhet të garantojë edhe implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Bisodiversitet 2011-2020, që është miratuar në fund të vitit të kaluar bashkë edhe me koston financiare të realizimit.
- Ministria e MPH-së duhet të zhvillojë kontakte më të shpeshta me institucionet komunale, gjegjësisht drejtoritë për menaxhim të zonave të mbrojtura në ato komuna ku janë krijuar dhe me zyrtarët e mbrojtjes së mjedisit që janë në kuadër të drejtorive për urbanizëm dhe planifikimit hapësinor, për të siguruar që këta zyrtarë janë të njoftuar me legjislacionin dhe janë duke e zbatuar atë në praktikë, ashtu siç përcaktohet më ligj.
- MMPH-ja brenda këtij viti do të duhej të nxjerrë të gjitha udhëzimet administrative dhe të ua dërgojë komunave në mënyrë që ta kenë më të lehtë zbatimin e këtij ligji në praktikë, dhe të ndikojë në ruajte më të mirë të natyrës.
- MMPH-ja duhet të organizojë punëtori regjionale me komunat, saktësisht me zyrtarët për mbrojtje të mjedisit, pasi që zyrtarëve lokalë u mungojnë përgatitja profesionale për të menaxhuar me zonat e mbrojtura, për të hartuar planet e veprimit për mbrojtje të natyrës, etj.
- Inspektorati mjedisor në kuadër të MMPH-së duhet të realizojë më shumë takime nëpër komuna që në bashkëpunim me inspektorët komunalë të bëjë më shumë inspektim të zonave të mbrojtura të natyrës, larmisë biologjike e peizazhore, diverzitetit, etj.
- MMPH-ja dhe komunat duhet të mbajnë më shumë takime me organizatat e shoqërisë civile që merren me mjedisin, pasi që do t'i ndihmonin shumë njëra tjetrës në realizimin e fushatave të ndryshme me qytetarë në promovimin dhe mbrojtjen e natyrës.
- Të organizohen fushata sensibilizuese, qoftë përmes konferencave për media, fletëpalosjeve, broshurave apo edhe radio e tv reklamave për të njoftuar publikun me pasuritë natyrore që kanë komunat e tyre dhe me veprimet që duhet ndërmarrë gjatë vizitave në ato zona.
- Instituti për Mbrojtje të Natyrës duhet të plotësohet me kuadrin e duhur, numër të duhur të personave të punësuar në mënyrë që të mund të bëjë monitorim profesional të aktiviteteve në mbrojtje të natyrës, inventarizimin e pasurive natyrore, ofrimin e ndihmës profesionale me kohë për të gjitha komunat e Kosovës dhe hartimin me kohë të raporteve mbi gjendjen e natyrës.
- Institutit për Mbrojtje të Natyrës t'i sigurohet një hapësirë e përshtatshme për punë dhe duhet t'u sigurohen mjete të punës, vetura për terren, etj. që ata të kenë mundësi të realizojnë punën e tyre profesionale ashtu siç është e përcaktuar me ligj.
- Komunat duhet të përfshihen gjatë hartimit të ligjeve, udhëzimeve administrative dhe strategjive në mënyrë që ato të japin vërejtjet dhe sugjerimt e tyre, të cilat do të inkorporohen brenda këtyre akteve ligjore, gjë që do të garantojë zbatim më të mirë të ligjit në terren.

XII. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

- Gjatë këtij viti duhet të themelohen të gjitha drejtoritë që do të menaxhojnë me zonat e mbrojtura, pasi që me themelimin e këtyre drejtorive do të sigurohet mbrojtja më e mirë e natyrës, dhe do të hartoheshin raporte me kohe mbi gjendjen e natyrës në secilën komunë.
- Komunat duhet të kenë një linjë të veçantë buxhetore për mbrojtje të mjedisit, gjë që do të sigurojë një mbrojtje më të mirë të natyrës, dhe do të rrisë aktivitetet vepruese të institucioneve komunale në mbrojtje të natyrës.
- Komunat duhet të organizojnë fushata të ndryshme nëpër institucionet arsimore, posaçërisht në shkollat fillore dhe të mesme, ku do të duhej të organizohen ligjërata për mbrojtje të natyrës dhe rëndësinë që ka natyra në komunat e tyre.
- Të paktën një herë në vit në secilën komunë të organizohen debate publike ku qytetarët do të njoftohen me punën e institucioneve në mbrojtje të natyrës, dhe me gjendjen e natyrës në komunën e tyre, gjë që do të ndikonte në vetëdijesimin e qytetarëve për të dhënë kontribut në ruajtje të natyrës.
- Të bëhet vendosja e tabelave njoftuese në hyrje të të gjitha zonave që janë nën mbrojtje dhe përkujdesje institucionale, me informacionet që ato zona duhet ruajtur dhe kërkojnë përkujdesjen e secilit.

XIII. Foto



XIII. Foto

Publikuar nga:

Syri i Vizionit

Mbeshtetur nga:

NDI
NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE